



BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUESE

Përgjegjës Sektori, *Spektori Mbrotja e Konsumatorit dhe Shërbimit të Veterianrisë*, **kategoria: III-a**

Lloji i diplomës shkenca natyrore/mjekësore

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Mallakastër**, shpall procedurat e lëvizjes paralele , ngritjes në detyrë, dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë e mesme dhe të ultë drejtuese, për grupin e pozicioneve:

Përgjegjës Sektori, *Spektori Mbrotja e Konsumatorit dhe Shërbimit të Veterianrisë në Drejtorinë e Mjedisit* - **kategoria: III-a**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LEVIZJE PARALELE:

08.10.2018

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

NGRITJE NË DETYRË:

11.10.2018

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

Përshkrim i Përgjithshëm

Mbrojtja e interesave të konsumatorëve në treg, si dhe përcaktimi i rregullave dhe ngritja e institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve. mban në kontroll të vazhdueshëm veterinarin frigoriferët shtetëror dhe private si dhe qendrat ftohëse provizore që sjellin dhe konservojnë produkte ushqimore ; ushtron kontrolle dhe merr masa për ruajtjen e shëndetit të popullatës nga sëmundjet që transmetohen nga kafshët tek njeriu ; kërkon dhe mbikqyr analizat laboratorike dhe të cilësisë dhe duke u mbështetur në to pajis çdo produkt me certifikatën përkatëse ; mban në kontroll të vazhdueshëm tregun e gjësë së gjalle, me qëllim evidentimin në kohë dhe rrjedhimisht marrjen e masave izoluese për ndonjë kafshë që klinikisht paraqesin shenjat e ndonjë sëmundje të rrezikshme ; bashkëpunon me drejtorinë e shëndetit publik dhe inspektoriatet sanitare, në drejtim të evidentimit dhe parandalimit të epidemive dhe sëmundjeve të tjera masive.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- është përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve të sektorit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit.
- është përgjegjës për korrigjimin e çdo shmangieje të konsiderueshme që mund të ekzistojë mes objektivave dhe rezultatit faktik.
- Kontrolli ndodh gjatë zhvillimit të punës dhe ushtrohet në bazë të autoritetit organizativ duke u mbështetur në rregulla, procedura dhe politika.
- Jep kontribut në procesin e vendimmarrjes të nivelit të mesëm drejtues, sipas fushës së ekspertizës, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara dhe analizave, të cilat mbështesin linjën e propozuar të veprimit.
- Ndjek zbatimin e sugjerimeve/rekomandimeve të lëna gjatë kontrollit të brendshëm financiar (auditi).
- Zgjidh probleme lidhur me aktivitetet e përditshme që ndikojnë në arritjen e rezultateve faktike të sektorit.
- Vendimmarrja është konstante, në përputhje me kuadrin ligjor, procedurat dhe standardet.
- raporton dhe përgjigjet direkt tek drejtori i drejtorisë i cili vendos mbi çështjet procedurale të lidhura me veprimtarinë e sektorit;
- puna në këtë pozicion ndikon në veprimtarinë e drejtorisë përkatëse.
- Ndan detyrat midis specialistëve të sektorit
- Bën velrësimin e specialistëve të sektorit sipas legjislacionit në fuqi
- Bashkë me specialistët ndjek konspodencën zyrtare

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1. LËVIZJA PARALELE

1.1

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA



Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a ;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Përgjegjës Sektori, *Sektori Mbrotja e Konsumatorit dhe Shërbimit të Veterianrisë në*

Drejtorinë e Mjedisit - kategoria: III-a

- Të jetë diplomuar në bachelor me profil shkencë natyrore/mjekësore
- Të ketë mbi 3 vite punë në profesion
- Të ketë Master Shkencor në fusha të ngjashme me bachelorin ose shkencë administrative/juridike

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë** në zyrën e **Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njërëzore**, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumente:
dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim të gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore.(Dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 08.10.2018.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 09/10/2018, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën paraprake të kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurrimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes emailit të paraqitur nga kandidati në dokumentacionin e aplikimit.



Kandidatët që nuk kualifikohen kanë të drejtë të paraqesin ankesë **brenda 3 tri ditëve kalendarike(09.10.2018-13.10.2018)** nga data e marrjes së njoftimit. në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe ankuesi merr përgjigje brenda **brenda 5 ditëve kalendarike** nga data e depozitimit të saj.

Në datë 14.10.2018, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall listën e verifikimit përfundimtar të kandidatëve si dhe datën dhe vendin e saktë se ku do të zhvillohet konkurrimi Konkurrimi intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambientet e Zyrës së Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër më datë **15.10.2018 ora 09:00.**

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi I Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligji 152/2013 Për nëpunësin civil I ndryshuar,
- Ligj Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin” I ndryshuar
- Ligj Nr.10 465, Datë 29.9.2011 Për Shërbimin Veterinar Në Republikën E Shqipërisë I ndryshuar

Si dhe akte nenligjore në zbatim të këtyre ligjeve

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i **pikës 23, të Kreut II** të Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr.242 dt.18.03.2015** ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’.

Komisioni më datë **15.10.2018** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me datë **15. 10.2018** do të njoftojë për rezultatet në mënyrë individuale , të gjithë aplikantët.

Të gjithë kandidatët pavarësisht nga e drejta për tu ankuar në gjykatë administrative, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, pranë Komitetit të pranimit të lëvizjes paralele, për rezultatin e pikëve,



brenda tri ditëve kalendarike nga data njoftimit individual(**nga data 15.10.2018-20.10.2018**), Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, kthen përgjigje ankuesit brenda pesë ditëve kalendarike (**20.10.2018- 25.10.2018**), nga data e përfundimit të afatit të ankimit .

Njësia përgjegjëse menaxhimit të burimeve njerëzore do të shpallë fituesin në **datë 25.10.2018**.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

2. NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e shërbimit kombëtar të punësimit,

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e shërbimit kombëtar të punësimit,

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Përgjegjës Sektori, *Spektori Mbrotja e Konsumatorit dhe Shërbimit të Veterianrisë në*

Drejtorinë e Mjedisit - kategoria: III-a

- Të jetë diplomuar në shkencë natyrore/mjekësore
- Të ketë mbi 3 vite punë në profesion
- Të ketë master shkencor në fusha të ngjashme me bachelorin ose në shkencë administrative dhe juridike

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë Kandidati duhet të dërgojë me postë në Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>



2. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID); ;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;;
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 11.10.2018, në adresë të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21.10.2018 NJBNJ** do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në stendën e informimit të publikut, **listën paraprake të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit., në rrugë elektronike nëpërmjet emailit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e depozitimit të saj. **(26.10.2018- 01.11.2018).**

Në datë **02.11.2018** do të publikohet lista përfundimtare e kandidatëve që vazhdojnë konkurrimin.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore"
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligj Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"
- Ligj nr. 120/2014 datë 18.9.2014 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligji nr.9887/datë 10.03.2008"për mbrojtjen e të dhënave personale" I ndrushuar

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;



- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër. Totali i pikeve të vlerësimit të kandidateve është 100 pike te cilat ndahen përkatësisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Konkurimi me shkrim do të zhvillohet në ambientet e Komunes Qender-Dukas më datë **09.11.2018 ora 09:00.**

Komisioni i Ngritjes ne detyre brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më date **10.11.2018**

I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve

Njerezore. Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, brenda dates 11.11.2018

shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakaster
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Mallakaster.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail :

mshehaj@bashkiamallakaster.gov.al

NJESIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

BASHKIA MALLAKASTËR

MARJOLA SHEHAJ



